

GJYKATË E HAPUR

GJYKATË E HAPUR
Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
korrik 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur"** Nr. 11, korrik 2018
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyquesori-rks.com



PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

STORIE E SUKSESIT

Raporti hulumtues i „Birnit,“ për Gjykatën Themelore të Prizrenit

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Moskuptimi si duhet i rolit që luan gjyqësori në sistemin tonë demokratik e shkatërron besimin e qytetarëve në institucionet tona të drejtësise

INTERVISTË E SHKURTË

Artan Sejrani (gjyqtar i Krimeve të Rënda)

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
korrik 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 11, korrik 2018

Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit

www.gjyqesori-rks.org

PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

STORIE E SUKSESIT

Raporti hulumtues i „Birnit,, për Gjykatën Themelore të Prizrenit

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Moskuptimi si duhet i rolit që luan gjyqësori në sistemin tonë demokratik e shkatërron besimin e qytetarëve në institucionet tona të drejtësisë

INTERVISTË E SHKURTË

Artan Sejrani (gjyqtar i Krimeve të Rënda)

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Drejtësia nuk është qëllim në vetvete. Ajo jepet për njerëzit dhe duhet të perceptohet prej tyre si e tillë. Njerëzit duhet ta ndjejnë thellë që drejtësia është e pavarur, e paanshme, e ndershme, e barabartë për të gjithë dhe e përgjegjshme. Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

Gjykata Themelore e Prizrenit synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.gjyqesori-rks.org ku publiku ka qasje edhe në publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme me të cilat publikime gjykata e Prizrenit prinë prej gjykatave tjera për nga numri i publikimeve të tyre. Sa i përket publikimit te aktgjykimeve deri në muajin qershor të vitit 2018 gjithsej kanë qenë mbi 1250 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, andaj për këtë sukses falënderoj stafin përgjegjës për kontributin e tyre në përgatitjen e aktgjykimeve për publikim në web faqen e gjykatës.


Përpjekje për avancimin e frysës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit nr. 11 që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënieς karshi qytetarëve. Përveç suksesit që ka kjo gjykatë ka edhe sfidat me të cilat po ballafaqohet çdo ditë. Njëra ndër sfidat kryesore është mungesa e bashkëpunëtorëve profesional, mungesa e stafit administrativ, si dhe mungesa e përkthyesve e të cilat paraqesin një sfidë sa i përket punës së kësaj gjykatë.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdoi të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.


STORIA E SUKSESIT

Monitorimi i Birnit për gjykatën Themelore të Prizrenit të paraqitura në mënyre tabelare për lëndët të zgjidhura dhe lëndë të pazgjidhura


Gjykata Themelore në Prizren



Gjykata Themelore në Prizren



Publikimi i aktgjykimeve në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018



Gjykata Themelore e Prizrenit kryeson dukshëm me publikimin e aktgjykimeve të plotëfuqishme. Grafika e mësipërme tregon publikimet e aktgjykimeve të plotëfuqishme në web faqen e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Në këtë rast, Gjykata Themelore e Prizrenit ka arritur që me punën dhe transparencën e saj të jetë ndër shembujt më pozitiv nga të gjitha Gjykatat e Kosovës edhe për vitin 2018.

Në web portalin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, mund t'i gjeni të publikuara mbi 1250 aktgjykime të plotëfuqishme, të anonimizuara ne përputhje me nenin 108 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës, nenit 4 paragrafi 1, pika 1.15 dhe pika 1.23 te Ligjit nr. 03/1-223 per Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2 te Ligjit Nr. 05/L - 032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L -199 për Gjykatat, nenin 3 dhe 12 te Ligjit Nr. 03/1-215 për Qasje ne Dokumente Publike dhe nenin 1.15 dhe 1.16 te Ligjit Nr.03/1-172 për Mbrojtje e të Dhënavë Personale.

Publikimi i aktgjykimeve të plotëfuqishme është një ndër mjetet kryesore për promovimin e transparencës gjyqësore përmes qasjes publike. Prandaj, ky grafikon është dëshmia e radhës e përkushtimit maksimal të gjykatës për të jetësuar praktikat e mira që mundësojnë efikasitet, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj.

Vajzat anëtare të Asamblesë së Fëmijeve të Komunës së Prizrenit, vizituan Gjykatën e Prizrenit



Me datën 20.04.2018, Gjykata Themelore e Prizrenit priti për vizit vajzat anëtare të Asamblesë së Fëmijeve të Komunës së Prizrenit për ndër të ditës së vajzave, ku u priten nga zyrtarja për informim publik, z. Afërdita Kicaj. Me këtë rast, fëmijët u njoftuan me strukturën e gjykatës si dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Pas prezantimit filletar, vijoi diskutimi i hapur me fëmijët. Çështjet për të cilat ato u interesuan më shumë kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, dhe kohëzgjatjen e dënimit me burg për të mitur. Ndërsa tjetra, u diskutua edhe mbi të drejtat e femrave me theks të veçant përfshirjen e tyre në trashëgimi.

Fëmijët paten rastin ta shohin objektin e gjykatës, sallat ku mbahen seancat gjyqsore, ku fëmijët shprehën interesimin e tyre për pjesmarrje në seancat gjyqësore te hapura për publikun. Gjykata vazhdon bashkëpunimin me të gjitha Institucionet, Shkollat, Universitetet dhe OJQ-të.

Nxënësit e Qendrës burimore për mësim dhe këshillim “Nënë Tereza” vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit



Me datën 24.04.2018, nxënësit e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” e cila merret me edukimin dhe arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta me dëmtime në të dëgjuar në të folur në Prizren së bashku me drejtorin e kësaj qendre profesorin dhe interpreten, vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit, ku u pritën nga zyrtarja për informim publik e kësaj Gjykate, z. Afërdita Kicaj. Qëllimi i kësaj vizite ishte që nxënësit të shohin punën dhe aktivitetet ditore në gjykatë në mënyrë që të njoftohen për së afërm me rëndësin e këtij institucioni.

Pas prezantimit fillestar, vijoi diskutimi i hapur me nxënësit. Çështjet për të cilat ata u interesuan më së tepërmi kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe kohëzgjatjen e dënimit me burg për të mitur. Ndër të tjera, ata u interesuan edhe mbi të drejtat e personave me nevoja të veçanta si dhe të drejtën e tyre që të kenë interpret gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore. Nxënësit paten rastin ta shohin objektin e gjykatës dhe sallat ku mbahen seancat gjyqësore.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur e cila vazhdon bashkëpunimin me të gjitha Institucionet, Shkollat, Universitetet dhe OJQ-të.

Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit Y.Hoxha, priti në një takim, ekspertët e buxhetit nga projekti JSSP-së James D.Gingerich (drejtor), John Ferry, zyrtarët e KGJK-së



Prizren, 08.05. 2018. Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit z. Ymer Hoxha, priti në një takim, ekspertët e buxhetit nga projekti JSSP-së James D.Gingerich (Drejtor), John Ferry, zyrtaret e KGJK-së (përfaqësues të Buxhetit, të Financave dhe të Burimeve Njerëzore), pjesëmarrës ishin administratori i gjykatës, zyrtari i financave, zyrtari i personelit dhe anëtarë tjerë të stafit administrativ. Qëllimi i këtij takimi ishin Udhëzimet për zhvillimet buxhetore 2019. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vënë në funksion përdorimin e buxhetit strategjik dhe të bazuar në përfomancë përgjatë zhvillimit dhe parashtrimit të kërkesave buxhetore për se cilën gjykatë në përgatitjen e kërkesave buxhetore për vitin 2018. Gjykata janë udhëzuar që të i bazojnë kërkesat e tyre buxhetore në prioritet strategjik për reduktimin e vonesave dhe avancimin e transparencës së procedurave gjyqësore si dhe rritjen e besimit të publikut. Procesi i zhvillimit të buxhetit këtë vit sërisht do të mbështetet në prioritete strategjike të përcaktuara nga KGJK-ja, njëkohësisht do të iu mundësoj gjykatave identifikimin e prioriteteve strategjike që janë unike për situatën e tyre. Gjykata do të i identifikojnë caqet e përfomancës sipas atyre prioriteteve.

Zyrat e KGJK-së për Buxhet dhe Burime njerëzore në bashkëpunim me projektin JSSP të USAID-it do të sigurojnë gjykatave ndihmë teknike të drejtpërdrejt në zhvillimin e kërkesave tyre buxhetore.

Punëtori për adresimin më efikas të kimeve të urrejtejes



Prizren, qershor 2018, Kuptimi dhe trajtimi i kimeve të urrejtejes, shkëmbimi i përvojave dhe identifikimi i mënyrave të bashkëpunimit ishin në qendër të diskutimit gjatë një seminari njëditor të organizuar nga ekipi i OSBE-së në Prizren në qershor 2018. Seminari ishte pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të OSBE-së për t'u ndihmuar autoritetet e tij të kuptuarit më të mirë të kimeve të motivuara nga paragjykimet.

Rreth 30 pjesëmarrës (26 burra dhe 4 gra), gjyqtarë, prokurorë, avokatë, mbrojtës të viktimate, bashkëpunëtorë profesionalë dhe pjesëmarrës të tjerë u mblodhën për të diskutuar mënyrat për identifikimin, hetimin dhe luftimin e kimeve të urrejtejes. Fjalimet e hapjes u mbajtën nga kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Ymer Hoxha; Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Admir Shala; kryetari i Odës Rajonale të Avokatëve Hajrip Krasniqi; dhe Zyrtari i Lartë Ligjor pranë OSBE-së, Meriton Pajaziti, i cili njëherit moderoi këtë punëtori.

Ndonëse aktivitet njëditor, punëtoria mbuloi një gamë të gjerë temash, duke përfshirë ndjekjen penale të kimeve të urrejtejes, kornizën ligjore për trajtimin e kimeve të urrejtejes në nivel vendor dhe ndërkombëtar, duke përfshirë praktikat e Gjykatës Evropiane per të Drejtat e Njeriut dhe informacionin se si të ndiqen penalisht këto raste. Vëmendja iu kushtua edhe ndihmës së viktimateve.

Në këtë drejtim, Faruk Mustafa, Zyrtar Vendor për Zhvillim të Policisë pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, para të pranishmëve dha prezantim rreth ndjekjes penale të kimeve të urrejtejes. Presantimi filloi me një përshkrim të shkurtër historik të temës për të vijuar më tej me

hulumtimin e konceptit të kimeve të urejtjes në mënyrë më të hollësishme, duke përfshirë karakteristikat që zakonisht mbrohen nga ligjet relevante; përdorimin e treguesve të paragjykimit për të identifikuar një rast të mundshëm të krimit të urejtjes; veprat penale të urejtjes dhe shkelësit; shembuj të treguesve të paragjykimit etj.

Në vijim, gjatë prezantimit të Meriton Pajazitit, përvèç përmendjes së kornizës ligjore që rregullon krimin e urejtjes ndërkombe tarisht dhe brenda vendit, Meriton i elaboroi mes tjerash dy raste të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Sheshiq kundër Kroacisë dhe Shkorjanec kundër Kroacisë), në të cilat u konstatua se autoritetet nuk përbushën detyrimin e tyre për të hetuar, ndjekur penalisht dhe për të gjykuar krimet e bazuara në motive paragjykimi.

Gjithashtu u theksua edhe përfshirja e OSBE/ODIHR-it në këtë temë. Lidhur me këtë, u prezantua faqja e ODIHR-it (hatecrime.osce.org/) ku janë të paraqitura informacione statistikore nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, shoqërisë civile dhe organizatave ndërqeveritare rreth numrave të raportuar të krimit të urejtjes. Nga ky prezantim pjesëmarrësit ishin në gjendje të kuptojnë se krimet në bazë të motivimit të paragjykimeve ndodhin kudo dhe mund të shohin përgjigjet përkatëse nga autoritetet përmes hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të këtyre kimeve.

Pjesa përfundimtare e prezantimit të Meritonit ishte Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për trajtimin e kimeve të urejtjes nënshkruar në vitin 2018. Pas kësaj, shkurtimisht u përmendën përgjegjësitet specifike që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke u nisur nga supozimi se për obligimet konkrete të cilat institucionet duhet ti ndërmarrin në lidhje me këtë marrëveshje do të konkretizohen nga institucionet përkatëse në nivel qendror. Në këtë drejtim, kryeprokurori dhe kryetari i Gjykatës shprehën gatishmërinë e tyre në zbatimin e këtyre përgjegjësive.



Në fund, organizimi i punëtorisë nga OSBE-ja dhe mbështetja e Gjykatës Themelore të Prizrenit bashkë me atë të Prokurorisë Themelore të Prizrenit u vlerësuan si një mundësi e shkëlqyer për diskutimet e ardhshme rreth shqetësimeve të përbashkëta në fushën e drejtësisë.

Gjykata Themelore e Prizrenit priti për vizitë 15 fëmijë të moshës 12-14 vjeçare të komunitetit boshnjak dhe rom për edukatë qytetare



Me datën 27.06.2018, Aktivistët e Organizatës, "Roma Versitas" - Dega në Prizren dhe vullnetares nga Amerika znj. Laura Sabato e cila është duke shërbyer vullnetarisht në kuadër të organizatës "Peace Corps" realizuan projektin në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Projekti kishte për qëllim të i mbledh 15 fëmijë të moshës 12-14 vjeçare të komunitetit boshnjak dhe rom për edukatë qytetare ku për një javë do i ftoj pesë institucione të ndryshme lokale të cilat do i flasin fëmijëve rreth rolit dhe shërbimeve që këto institucione i ofrojnë qytetarëve, kryesisht këto institucione janë 1. Policia e Kosovës 2. Zjarrfikësit 3.Gjykata Themelore e Prizrenit 4.Spitali i Prizrenit si dhe Komuna e Prizrenit.

Trajnimi ka filluar me datën 25 dhe do të përfundon me datën 29 qershor (një ditë për secilin institucion dhe dita e parashikuar për Gjykatën Themelore të Prizrenit është data 27.06.2018.Trajnimi është mbajtur në lokalet e OJQ-së "Roma Versitas" në kompleksin "Europa" në dy pjesë, në pjesën teorike zyrtarja për informim publik Afërdita Kicaj i'u tregoj fëmijëve për shërbimet që ju ofron gjykata për qytetarët për të rejat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takimet direkt me kryetarin e gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun, rëndësi të veçante i kushtoi edhe transparencës së gjykatës e cila synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës ne veçanti. Ndërsa në pjesën praktike fëmijët patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës si dhe patën mundësi ta marrin buletinin informativ i cili publikohet në baza tre mujore përmes së cilës informohen qytetarët mbi punën dhe aktivitetet e kësaj gjykate.

Gjykata vazhdon traditën e bashkëpunimit me qytetarët me OJQ-të me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit me degët në Suharekë dhe Dragash për gjashtë mujorin e parë për vitin 2018, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2018, të ardhura, lëndët në proces, lëndë që janë përfunduar në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, dhe ato të mbetur. Statistikat e punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 janë dëshmia numerike e përkushtimit maksimal për ti shërbyer qytetarëve.

Tabela e statistikave

Gjykata Themelore Prizren

Gjykata Themelore Në Prizren	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim te 2018	Lëndët e ardhura gjate VI - MUJORIT 2018	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e kryera gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e mbeturat në fund të VI - MUJORIT 2018	Perqindja e lendeve te zgjidhura ne VI - MUJORIT 2018
Dep. Për Krimë Të Rënda	Penale	113	56	169	73	96	130,36
	Paraprake	199	48	247	35	212	72,92
Dep. I Pergithshëm	Penale	3632	1027	4659	1494	3165	145,47
	Paraprake	1125	300	1425	72	1353	24,00
	Civile	1346	1026	2372	630	1742	61,40
	E.Civile	6189	1209	7398	1163	6235	96,20
	E.P. Me Burg	31	54	85	55	30	101,85
	E.P. Me Gjobë	612	450	1062	399	663	88,67
	Të Ndryshme	0	8487	8487	8487	0	100,00
	Trashegimore	26	37	63	47	16	127,03
	Jashtkontestimore	540	278	818	291	527	104,68
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegit	216	81	297	62	235	76,54
	Pregaditore	88	111	199	93	106	83,78
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3480	1214	4694	2829	1865	233,03
TOTALI		17597	14378	31975	15730	16245	109,40

Gjykata Themelore – dega - Suharekë

Gjykata Themelore Në Prizren-Dega Në Suharekë	Lëmia	Lëndët e trashëgura në fillim te 2018	Lëndët e ardhura gjate VI - MUJORIT 2018	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e kryera gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e mbetura në fund të VI - MUJORIT 2018	Perqindja e lendeve te zgjidhura ne VI - MUJORIT 2018
Dep. Për Krimë Të Rënda	Penale						
	Paraprake						
Dep. I Përgjithshëm	Penale	1502	300	1802	457	1345	152,33
	Paraprake	109	50	159	67	92	134,00
	Civile	828	344	1172	254	918	73,84
	E.Civile	1713	278	1991	195	1796	70,14
	E.P. Me Burg	114	8	122	52	70	650,00
	E.P. Me Gjobjë	253	107	360	136	224	127,10
	Të Ndryshme	0	964	964	964	0	100,00
	Trashegimore	54	7	61	6	55	85,71
	Jashtkontestimore	109	54	163	61	102	112,96
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegit						
	Pregaditore						
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3189	488	3677	787	2890	161,27
	TOTALI	7871	2600	10471	2979	7492	114,58

Gjykata Themelore – dega - Dragash

Gjykata Themelore Në Prizren-Dega Në Dragash	Lëmia	Lëndët e trashëgura në fillim te 2018	Lëndët e ardhura gjate VI - MUJORIT 2018	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e kryera gjatë VI - MUJORIT 2018	Lëndët e mbetura në fund të VI - MUJORIT 2018	Perqindja e lendeve te zgjidhura ne VI - MUJORIT 2018
Dep. Për Krimë Të Rënda	Penale						
	Paraprake						
Dep. I Përgjithshëm	Penale	315	70	385	121	264	172,86
	Paraprake	9	19	28	27	1	142,11
	Civile	278	56	334	62	272	110,71
	E.Civile	452	46	498	45	453	97,83
	E.P. Me Burg	2	0	2	0	2	#DIV/0!
	E.P. Me Gjobjë	81	16	97	36	61	225,00
	Të Ndryshme	0	1297	1297	1297	0	100,00
	Trashegimore	29	1	30	1	29	100,00
	Jashtkontestimore	58	55	113	47	66	85,45
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegit						
	Pregaditore						
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	165	59	224	30	194	50,85
	TOTALI	1389	1619	3008	1666	1342	102,90

GJYKATA NË MEDIA

Moskuptimi si duhet i rolit që luan gjyqësori në sistemin tonë demokratik e shkatërron besimin e qytetarëve në institucionet tona të drejtësisë

Gjykata ka reflektuar në mënyrë pozitive duke qenë bashkëpunuese dhe ka një nivel të mire të transparencës. Gjatë gjashtë majorit të parë të vitit 2018 – Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar 98 komunikata të cilat kanë pasur për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe shqiptimin e dënimive në rastet gjyqësore, njoftime për vizitat në gjykatë, takimet e punës dhe tryezat, si dhe ka publikuar mbi 1250 aktgjykime të plotfuqishme.



Si gjykata e vetme në Kosovë, Zyra për Informim me mjaft sukses po e publikon numrin e njëmbëdhjetë (11) të Buletinit Informativ “Gjykatë e Hapur”, e cila është një dritare e transparencës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Jemi tejet të motivuar që këtë mjet të transparencës po vazhdojmë ta mbajmë gjallë.

Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha mediat lokale, të cilat kanë transmetuar në mjetet e tyre të informimit në nivel shumë të kënaqshëm ngjarjet dhe materialet e shpërndara nga Gjykata. Ju falënderojmë për kontributin e juaj për një gjykatë të hapur dhe transparente.

INTERVISTË E SHKURTË

Gjykata Themelore e Prizrenit, me prioritet ka shqyrtuar edhe zgjidhjen e lëndëve me natyrë korruptive në mënyrë që të njëjtat të përfundohen brenda periudhave sa më të shkurtëra kohore. Me një përkushtim të tillë, punon edhe Artan Sejrani, gjyqtar i Krimeve të Rënda, në Gjykatën Themelore të Prizrenit të cilin e ftuan për intervistën e shkurtër të këtij numri



Artan Sejrani

gjyqtar në Departamentin
e Krimeve të Rënda

1. Sa efikase është Gjykata Themelore ne punën e saj?

Gjykata Themelore në Prizren viteve të fundit ka treguar efikasitet të lartë në punën e vet. Duke u bazuar në gjendjen aktuale si dhe në raportet e fundit statistikore mund të themi se kemi bilanc pozitiv me lëndët e kryera dhe të pranuara. Në një trend të tillë të efikasitetit sigurisht ka ndikuar puna profesionale e gjyqtarëve dhe e stafit administrativ, poashtu, edhe plotësimi i vendeve të lira për gjyqtar, duke ndikuar edhe ne rritjen e shkallës së spastrimit të lëndëve gjatë muajve vijues. Gjykata Themelore e Prizrenit, me prioritet ka shqyrtuar edhe zgjidhjen e lëndëve me natyrë korruptive, në mënyrë që të njëjtat të përfundohen brenda periudhave sa më të shkurtëra kohore. Megjithatë, numri i lëndëve të pazgjidhuara edhe më tutje mbetet sfidë për gjykatën.

2. Sa sfiduese është puna e juaj duke pasur parasysh natyrën specifike të profesionit që keni?

Puna e gjyqtarit është shumë komplekse dhe një sfidë në vete, ngase përgjegjësia që ka një gjyqtar gjatë gjykimit të një rasti është tepër e lartë. Në Departamentin e Krimeve të Rënda ku edhe unë jam pjesë e tij, trajtohen rastet më delikate. Departamenti i Krimeve të Rënda gjykon rastet me mbi 10 vjet burgim apo rastet të cilat janë paraparë me nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si raste më specifike, dhe se këto raste trajtohen nga trupi gjyques që përbëhet prej 3 gjyqtarëve profesional. Sfida jonë për dhënien e drejtësisë kërkon domosdoshmërisht integritet dhe etikë në figurën e gjyqtarit, por edhe integritet në sistemin gjyqësor në tërësi.

3. Cilat parime i ndjekni gjatë ndarjes së Drejtësisë?

Ne si gjyqtar jemi të obliguar t'i zbatojmë parimet e përgjithëshme të drejtësisë që janë: gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, prezumimi i pafajësisë, gjykimi në afat të arsyeshëm, transparenca, barazia e palëve, etj. Këto parime janë bazë në drejtësi në mënyrë që edhe çështja penale të ketë epilog të drejtë dhe të bazuar në ligj. Zhvillimi i gjykimit në respektim të procesit të rregullt ligjor, të parimeve themelore të drejtësisë dhe i finalizuar me dhënien e një vendimi gjyqësor të bazuar në ligj dhe në prova, kërkojnë profesionalizëm dhe integritet, pikësëpari nga unë si gjyqtar dhe nga kolegët e mi si dhe më tej nga akterët e tjera të sistemit gjyqësor në tërsi.

4. Hulumtimet tregojnë për nivel jo të madh të besimit të qytetarëve ndaj Gjykatës. Pse ndodh kjo? Si reagoni si gjyqtar kur dëgjoni raporte të tillë?


Edhe pse në publik flitet për mosbesim të qytetarëve në gjykata, viteve të fundit gjërat kanë ndryshuar. Andaj, mund të themi se është ngritur sado pak besueshmëria karshi gjykatës dhe se shumë qytetarë i drejtohen gjykatave për realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë ligjore. Gjykata jonë ka zyrën për informim përmes së cilës publiku ka qenë i informuar rregullisht mbi punën dhe veprimtarinë e gjykatës, përmes portalit gjyqësor, e po ashtu edhe rrjeteve sociale, si me orarin e seancave, njoftimet e ndryshme ashtu edhe me vendimet gjyqësore, të cilat i kanë mundësuar publikut qasje më e lehtë në punën e gjykatës. Në fund, mund të themi se shumë herë këto, raporte nuk kanë qenë të sakta dhe se kanë qenë në kundërshtim me statistikat zyrtare të gjykatave. Ne si gjyqtarë mundohemi që rastet t'i trajtojë në mënyrë ligjore dhe në afat dhe se me punën që bëjmë padyshim që edhe besueshmria e qytetarëve do të rritet.

5. A mendoni se gjykimi publik është një ndër elementet thelbësore për një gjykim të drejtë? Si e përceptoni këtë?

E drejta për gjykim publik është e drejtë universale, poashtu e drejtë që i garantohet çdo qytetari me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet penale. Në Gjykatën Themelore në Prizren, është e mundur prania e opinionit në seanca gjyqësore, që nënkupton praninë e të gjithë personave të interesuar dhe në mënyrë që seancat tëjenë sa më transparente. Mirëpo, në procedurën penale, gjykata mund të përjashtojë opinionin nga tërë shqyrtimi kryesor ose nga ndonjë pjesë e tij nëse është e nevojshme për shkak të ruajtjes së sekretit, ruajtjes së rendit publik, mbrojtjes së moralit, mbrojtjes së jetës personale dhe intime të të akuzuarit, dëshmitarit ose të dëmtuarit dhe për mbrojtjen e interesave të të miturit.

SI TI QASEMI GJYKATËS ?

Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.



Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.



A e dini se...?!

(Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje)

Dhunë ne familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin eshtë ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

- 1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;
- 1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
- 1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
- 1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
- 1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
- 1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qellim te përuljes se personit tjetër;
- 1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
- 1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- 1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
- 1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën qe ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.





**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU
PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN**



**Kontaktoni
Gjykatën Themelore
të Prizrenit**

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa:
**Gjykata Themelore
e Prizrenit**
Rr. "Ibrahim Lutfiu ",
p.n. Prizren, Kosovë

GJYKATË E HAPUR
Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
korrik 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 11, korrik 2018
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org

Vizito:
www.gjyqesori-rks.org